

### Formular për SYLLABUS të Lëndës Qeverisja Korporative

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	FAKULTETI EKONOMIK, Programi: BANKA/FINANCA
Titulli i lëndës:	Qeverisja Korporative
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Semestri III (Viti i II-të)
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	4 ECTS
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.ass.dr. Arbër Hoti, AC, KC, ABC
Detajet kontaktuese:	arber.hoti@uni-pr.edu

<b>Përshkrimi i lëndës:</b>	Programi mësimor i lëndës Qeverisja Korporative, njofton studentët me kodet kryesore dhe praktikat më të mira të qeverijse së korporatave dhe zbatimit të tyre praktik në Kosovë.
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Qëllimi i kësaj lënde është të prezantohet roli i qeverisjes së korporatave, dhe rëndësinë e saj për bizneset kombëtare dhe ndërkombëtare në të gjithë sektorët. Çështjet kyçe do përfshijnë: rolin dhe funksionin e bordeve të drejtorëve; roli i jashtëm dhe i brendshëm auditorët; komitetet e auditimit; teorinë e palëve të ndërlidhura dhe agjencisë; CSR; ndikimi i dështimi i qeverisjes korporative dhe etika e biznesit dhe tema të tjera që ndrlidhen ngushtë me procesin e qeverijes së korporatave.
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	Në përfundim të ciklit të ligjëratave nga kjo lëndë, studentët duhet të jenë të aftë: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Të shpjegojnë rrënjët historike të Qeverisjes Korporative</li> <li>2. Shpjegojnë teorinë e ndryshme të Qeverisjes Korporative: teoria e agjencisë, palëve të interesit dhe kujdestarisë.</li> <li>3. Vlerësojnë rolin e menaxhmentit, investitorëve dhe palëve me interes</li> <li>4. Të interpretoj kodet kombëtare dhe ndërkombëtare të qeverisjes korporative</li> <li>5. Të vlerësoj efektivitetin e sistemeve të ndryshme të qeverisjes korporative.</li> </ol>

Kontributi në ngarkesën e studentit			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej orë
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike	-	-	-
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	10	10

Ushtrime në teren	-	-	-
Kollokiume, seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	1	4	4
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgatitja përfundimtare për provim	2	3	6
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	3	6
Projektet, prezantimet, etj.	2	5	10
<b>Totali</b>			<b>100</b>

<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	<p>Mësimdhënia do të zhvillohet përmes ligjëratisë, detyrave praktike, interpretimeve individuale e grupore, punimit të seminareve, vetëvlerësimeve periodike, etj. Ligjëratat do të realizohen duke i prezantuar materialet në formën audio-vizuale përmes teknologjisë elektronike me programet e Windows Office.</p> <p>Në aspektin teorik do të ofrohen njohuri të përgjithshme shkencore, bazuar në literaturën bashkëkohore.</p> <p>Pjesa praktike kryesisht do të realizohet përmes shembujve konkret nga literatura dhe nga njohuritë praktike në ndërmarrjet prodhuese private e publike dhe te organizatat jofitimprurëse.</p> <p>Përmes kësaj metodologjie synojmë krijimin e raporteve ndër-vepruese profesor–student si dhe ai student-student.</p>
-------------------------------------	--

<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<p>Studentët duhet të jenë pjesëmarrës aktivë të procesit mësimor. Mësimi aktiv kërkon që studentët të reflektojnë mbi gjërat që diskutohen e jo të jenë pranues pasivë të informative që u jepen. Ata janë inkurajuar që të shtrojnë pyetje. Po ashtu do të organizohet edhe puna grupore, në mënyrë që studentët të diskutojnë çështjet relevante dhe të këmbëjnë mendimet e tyre. Natyrisht, paraprakisht do të kërkohet leximi dhe thellimi në literature relevante të lëndës.</p>
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<p>Vlerësimi i studentëve konsiston në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pjesëmarrja aktive në L+U: 20 pikë</li> <li>• Testi I 40 pikë</li> <li>• Testi II 40 pikë</li> </ul>

<b>Literatura</b>	
Literatura bazë:	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Praktika Profesionale P12, BPP Learning Media, Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (SCAAK)</li> </ul>
Lieratura plotësuese:	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligji mbi Shoqëritë Tregtare të Kosovës;</li> <li>• Ligji mbi Qeverisjen Korporative të Bankave në Kosovë;</li> <li>• Materiale tjera nga ligjeruesi.</li> </ul>

<b>Plani i dizajnuar i mësimi:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjërata që do të zhvillohet</b>
Java e parë:	Hyrje
Java e dytë:	K1: Objektivi i qeverisjes së korporatës
Java e tretë:	K1: Objektivi i qeverisjes së korporatës (vazhdim)
Java e katërt:	K2: Qasjet ndaj qeverisjes së korporatës
Java e pestë:	K3: Praktikat e qeverisjes së korporatës dhe raportimi i tyre
Java e gjashtë:	K4: Kontrollat e Brendshme
Java e shtatë:	<b>Testi 1</b>
Java e tetë:	K5: Auditimi i brendshëm
Java e nëntë:	K7: Vlerësimi i Rreziqeve
Java e dhjetë:	K8: Kontrollat mbi rreziqet
Java e njëmbëdhjetë:	K9: Kërkesat për informacion dhe raportimit
Java e dymbëdhjetë:	K10: Etika dhe interesi publik
Java e trembëdhjetë:	K11. Kontrollat mbi rreziqet
Java e katërmëdhjetë:	Rastet e dështimeve korporative
Java e pesëmbëdhjetë:	<b>Testi i dytë</b>
<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>	
<p>Vijimi i rregullt i ligjëratave dhe ushtrimeve është i obliguar për të gjithë studentët e rregullt. Të gjithë studentët janë të obliguar që t'i përfillin rregullat e mirësjelljes: mbajtja e qetësisë, ç'kyqja e telefonave celularë dhe hyrja në sallë me kohë.</p>	